# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-398667**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Persona të armatosur e kërcënuan dhe gjobitën 5 mln euro, kush është Vasil Bedinaj, pronar i “Regina Hotel” – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/vlora-kthehet-ne-skene-filmi-10-persona-te-armatosur-kercenojne-pronarin-e-regina-hotel-pastaj-aksidentohen-kush-eshte-vasil-adebinaj/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 6 shtator 2026, 00:17:56 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 3 shtator 2026, 12:31:32 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a9eaca18658a6333a0ce459d19f51c6bdf751e86525581c3e7ff16ecd4acc7c6` |
| TEKSTI | `98cfe2883ef343b528f5f37b1cb554fe5d1f63cbbe0500023c1b988ee3456529` |
| PAMJA | `646739b5a1e1566e4a85c332f87cec57e837d02ffd478e8e767b6ab4f1765d9e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `88120e881f4f058291ad4945a8e895b6cb2502a0111da5576ce12fa268c3a45a` |
| E MËPARSHMJA | `6f650453b90bc44891badc3aace855af67e061a23ad134d2b5b78eaef743f440` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/88120e881f4f058291ad4945a8e895b6cb2502a0111da5576ce12fa268c3a45a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

zonën e Orikumit, në Vlorë, ku një grup prej më shumë se 10 personash, shumica prej tyre të armatosur, dyshohet se kanë shkuar për t'i vendosur gjobë pronarit të hotelit, Vasil Bedinaj.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 12:30 .Sipas informacioneve paraprake, personat fillimisht kanë kërcënuar me fjalë Bedinajn, ndërsa më pas kanë përdorur edhe armët, duke i kërkuar një shumë prej 5 milionë eurosh.

Mes palëve ka pasur edhe një konflikt fizik, ndërsa autorët janë larguar nga ambientet e hotelit menjëherë pas ngjarjes.

Në vendngjarje kanë mbërritur shërbimet e Policisë, të cilat kanë nisur ndjekjen e autorëve. Gjatë ndjekjes, dy persona, që udhëtonin me një automjet, janë aksidentuar në urën e Peshkëpisë, në hyrje të Vlorës.

Të plagosurit janë transportuar me ambulancë drejt spitalit. Sipas informacioneve paraprake, njëri prej tyre ka marrë dëmtime të shumta në shpinë dhe në shtyllën kurrizore, ndërsa personi tjetër ka pësuar dëmtime nga aksidenti.

Ndërkohë, forca të shumta policie janë shpërndarë në disa zona të qytetit të Vlorës, në përpjekje për të bërë të mundur kapjen e personave të përfshirë në këtë ngjarje.

Policia po vijon kontrollet dhe hetimet për të zbardhur rrethanat e plota të ngjarjes, ndërsa informacionet mbeten paraprake.

**Kush është Vasil Bedinaj**

5 Viti i ri shkollor nis edhe në burgun e Korçës, 31 të dënuar ndjekin...

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

Vasil Bedinaj është pronari i Hotel Regina.  Ai është përfshirë edhe më herët në disa incidente që kanë tërhequr vëmendjen e opinionit publik.

Në korrik të vitit 2025, emri i tij u përmend në një konflikt ku u dhunua kamarieri 18-vjeçar  Ron Balaj.

Sipas raportimeve të kohës, Balaj ishte dhunuar nga ish-oficeri i Policisë Kufitare të Dibrës, Ardian Isufi, së bashku me Leart Bimon. Në konflikt ndërhyri edhe Bedinaj, i cili goditi ish-efektivin.

Ngjarja shkaktoi reagime të shumta publike dhe u komentua edhe nga kryeministri Edi Rama.

Një tjetër episod lidhet me verën e vitit 2024, kur Bedinaj u filmua duke goditur me grusht një qytetar pas një debati për hapësirën në plazh.

Pas publikimit të pamjeve, biznesmeni u shfaq në një video së bashku me personin që kishte goditur, duke deklaruar se ngjarja kishte ndodhur rreth një muaj e gjysmë më parë dhe se të dy ishin biznesmenë në sektorin e turizmit në Vlorë.

#VasilBedinaj


**Xhuljana Zhuleku**

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.







© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.